



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 17522 Prot

Tiranë, më 24.7.2018

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi

Për publikim: **Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit**

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të Kreut I të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 921 datë 29.12.2014 "Për personelin e Administratës Doganore", i ndryshuar, shpall konkurimin e hapur për pozicionin:

- **Përpunues Informacioni** në Departamentin Operativ Hetimor, Kategoria C3 (1 vend)

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kriterë:

1. Të kenë shtetësi shqiptare;
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të gëzojnë shëndet të mirë për të kryer detyrat e tyre;
4. Të mos kenë qenë të dënuar për krime dhe që nuk gjykohen për një çështje penale në ngarkim të tyre;
5. Të mos kenë qenë pushuar ndonjëherë më parë nga puna për thyerje të disiplinës ose shkelje të tjera serioze;
6. Të kenë të paktën arsim të mesëm.
7. Të kenë njohuri në përdorimin e kompjuterit;
8. Njohjen e një gjuhe të huaj.

Përshkrim përgjithsues për pozicionin:

- Siguron dorëzimin e plotë dhe në kohë të dokumenteve që krijohen apo hyjnë në Departamentin Operativ Hetimor gjatë vitit duke përditësuar databazën e shkresave brenda këtij Departamenti.

- Krijon mundësi dhe kushte për shfrytëzim operativ të dokumentacionit duke bërë evidentimin e tyre.
- Administron procedurat lidhur me hyrje-daljet e shkresave brenda Departamentit Operativ Hetimor.
- Shpëndan korrespondencën e shkresave brenda Departamentit Operativ Hetimor kundrejt firmës.
- Përbush çdo detyre tjetër të ngarkuar nga Zv. Drejtori i Përgjithshëm i DOH brenda fushës së detyrave funksionale.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë vijon:

1. Kërkesë për marrje pjesë në konkurim;
2. Curriculum Vitae (dhe letër motivimi);
3. Diplomë e shkollës së mesme (ose e shkollës së lartë) e noterizuar;
4. Dëshmi Penaliteti (do të vihet në dispozicion nga DMBNJ pas plotësimit të formularit të vetdeklarimit);
5. Vërtetim nga Gjykata;
6. Vërtetim nga Prokuroria;
7. Vërtetim nga Tatim-Taksat (nga portali e-Albania);
8. Raport mjeko-ligjor;
9. Kartë identiteti;
10. Fotokopje të librezës së punës;
11. Fotokopje të kurseve kualifikuese;
12. Letër referencë dhënë nga punëdhënësi/eprori direkt i pozicionit të fundit.

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më sipër.

Procedura e përzgjedhjes bëhet nëpërmjet vlerësimit të dosjes personale dhe me intervistë. Kandidatët që marrin mbi 50 pikë në vlerësimin e dosjes konsiderohen të kualifikuar për të marrë pjesë në intervistë. Kandidatët e përzgjedhur duhet të marrin mbi 70 pikë në intervistë. Rezultatet e intervistës bazohen në vlerësimin e përvojës, në kualifikimin dhe aftësitë e kandidatit.

Data e intervistës do të caktohet në një njoftim të dytë.

Për të qenë pjesëmarrës në konkurrim, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 30.07.2018, ora 16:00 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Belinda Ikonomi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV. DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Arben Seferi

